



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.128, datë 24.12.2020

MBI

MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË NDËRTESËS ME EMËRTIMIN “AMBULANCË - KULLË - SUKTH I RI”, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH, QË MBAN NR. 141 TË LISTËS PARAPRAKE, MIRATUAR ME VKM NR. 297, DATË 28.4.2010, PËR SHKAK SE ËSITË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE ËSHTË REKOMANDUAR TË DEMOLOHET, SIPAS AKTEKSPERTIZËS, REALIZUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË DHE MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PARAPRAKE, TË PRONËS ME NR.141, ME VENDODHJE NË FSHATIN KULLË, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH, ME EMËRTIMIN “AMBULANCË - KULLË - SUKTH I RI”

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 297, datë 28.04.2010 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Sukth, të Qarkut Durrës”, VKM-së nr.796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr.887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, i ndryshuar, shkresës nr. 182/38 prot., datë 25.9.2020, ardhur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me lëndë “Dërgim akt ekspertizë e thelluar”, ligjit nr. 10296/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Sektori i Pronave Publike Dhe Menaxhimit të Aseteve pranë Drejtorisë Ligjore të Bashkisë, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:



1. Miratimin për prishjen e detyruar të ndërtesës me emërtimin “Ambulancë - Kullë - Sukth i Ri”, Njësia Administrative Sukth, që mban nr. 141 të listës paraprake, miratuar me VKM nr.297, datë 28.4.2010, për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 Nëntor 2019 dhe është rekomanduar të demolohet dhe të bëhet një projekt i ri dhe i plotë, duke marrë parasysh kushtet gjeologjike dhe sizmike të zonës ku do të ndërtohet, realizuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista paraprake, të pronës me nr.141, me vendodhje në fshatin Kullë, Njësia Administrative Sukth, me emërtimin “Ambulancë - Kullë - Sukth i Ri”.
2. Miratimin për heqjen nga lista paraprake e pronave të Njesisë Administrative Sukth, Bashkia Durrës, të pronës me nr. 141, me vendodhje në fshatin Kullë, Njësia Administrative Sukth, që i përket ndërtesës me emërtimin “Ambulancë - Kullë - Sukth i Ri”, që me VKM nr. 297, datë 28.4.2010, bën pjesë në listën paraprake të pronave të Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës).
3. Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Njësia Administrative Sukth, që në zbatim të ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronës me nr.141, me vendodhje në fshatin Kullë, Njësia Administrative Sukth, që i përket ndërtesës me emërtimin “Ambulancë - Kullë - Sukth i Ri”, Njësia Administrative Sukth, që me VKM nr. 297, datë 28.04.2010, bën pjesë në listën paraprake të pronave të Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës).
4. Toka (trualli), i liruar nga prishja e godinës e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoret për rindërtimin e godinës së dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shembjen e godinës të përcaktuar në pikën 1 të vendimit, të mbulohen nga institucionet përkatëse, Inspektoriat i Mbrojtjes Territorit Vendor, Durrës
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkërendojnë punën me Njësine Zbatuese (Fondin e Zhvillimit), që administrojnë fondet për rindërtim, që transferohen nga Këshilli i Ministrave, prej fondit të rindërtimit, për të realizuar rindërtimin e godinës me emërtimin “Ambulancë - Kullë - Sukth

i ri”, fshati Kullë, Njësia Administrative Sukth, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të godinës, pas realizimit të rindërtimit.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Pronave Publike Dhe Menaxhimit Të Aseteve pranë Drejtorisë Ligjore.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).



KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 24.12.2020




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 1103 prot.
12



Durrës, më 30 /12/2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës

Verifikova ligjshmërinë e vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.128 datë 24.12.2020

“Miratimin për prishjen e detyruar të ndërtesës me emërtimin “ambulancë - kullë - sukth i ri”, njësia administrative sukth, që mban nr. 141 të listës paraprake, miratuar me vkm nr. 297, datë 28.4.2010, për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe është rekomanduar të demolohet, sipas aktekspertizës, realizuar nga instituti i ndërtimit tiranë dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista paraprake, të pronës me nr.141, me vendodhje në fshatin kullë, njësia administrative sukth, me emërtimin “ambulancë - kullë - sukth i ri””.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

